



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 16.02.2024
NR.09/ 1526 / 2024

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës ¹: 659-24-925-2-4-7& KKHE(VM) 24-001-247

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

DEA GROUP SH.P.K., PRISHTINE, 10000, KOSOVO ne vazhdim "realizuesi i shërbimit me NUL811454636, ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për realizimit e shërbimit i shënuara me poshtë:

Hartimi i projektit kryesor "Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 - Hani i Elezit "KKHE(VM) 24-001-247" me numër identifikues: 659-24-925-2-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga realizimit i shërbimit-hartimi i projektit si në vijim:

Nr.	Grupi
1	Hartimi i projektit kryesor "Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 - Hani i Elezit "KKHE(VM) 24-001-247"

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. *Kohëzgjatje e kontrates eshte me afatë prej 60 diteve nga koha e nënshkrimit te saj*

2.2 Vendi i dorëzimit të shërbimit -hartimi i projektit do të jetë Komuna Hani i Elezit

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i shërbimit duhet të jetë: 972.00 € [Nëntqind e shtatëdhjetë e e dy Euro/00 centi]

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë realizuesi të shërbimit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.-Çmimi është i prerë dhe nuk i nënshtrohet ndryshimeve gjatë kohëzgjatjes së kontratës]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Nderkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i realizuesit të shërbimit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe ³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.


Për Autoritetin Kontraktues

KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Avdush BAJRAMLIU
Pozita:	Zyrtar i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	16/02/2024
Vula:	

Për realizuesin e shërbimit

DEA GROUP SH.P.K.

Emri:	Durim Hoxha
Pozita:	Perfaqesues me autorizim
Nënshkrimi:	
Data:	16/02/2024
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-24-925-2-4-7

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore Ferizaj Dega ne Kaçanik
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	[N/A]
Sigurimi	10.1	[N/A]
Programi i ekzekutimit	11	[Kohëzgjatje e kontrates eshte me afatë prej 60 diteve nga koha e nenshkrimit te saj]
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Te gjitha taksat dhe tatimet mbulohen nga OE-deri ne dorezimin tek AK-ja
Patentat dhe licencat	13.1	[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]
Cilësia e furnizimeve	18.2	Sherbimi i hartimit te projektit do te behet ne sipas listes se pershkrimit e sherbimit te AK-së dhe duhet te behet me at cilesi siq eshte kerkuar ne ftesen per ofertim-dosje te tenderit
Inspektimi dhe testimi	19.2	AK- do te kontrolloj cilësin e realizimit te sherbimit dhe ne kohen e pranimit te tij Hartimi i projektit duhet te behet ne kopje te mjaftueshme do te pranohet nese eshte konform kesaj kontrate] Per ecurin dhe realizimin e kesaj kontrate kujdeset DUKMM-ja
Pagesa	20.1	Pagesa do te behet pas pranimit te sherbimit ne cilesi dhe sasi ashtu siq ka percaktuar AK-ja [Pagesa do te behet brenda afatit ligjor pas pranimit te flatures konform ofertes]
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre
Obligimet e garancionit	24.1	Hartimi i projekti duhet te behet konform rregullva per hartim projekt dhe duhke dalur ne teren bashk me njesin kerkuese DUKMM-ne
	24.5	[N/A]
Shërbimet pas shitjes	25.1	[N/A]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose permes procedurave alternative te zgjidhje se mosmarrveshjeve-procedurat e ndermjetesimit me pajtimin e te dy palve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata theme]ore Ferizaj Dega ne Kaçanik] në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].